
	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 05.04.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: HAXHA KOM SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rikonstruimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave” – Lot 2, me Nr. të Prok: 616-22-14684-5-1-1 nxjerr:**

## V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: HAXHA KOM SH.P.K. e parashtruar me datë: 05.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rikonstruimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave” – Lot 2, me Nr. të Prok: 616-22-14684-5-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin për Kontratë të AK –së, të datës 31.03.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. **Autoriteti Kontraktues, vendos për të rivlerësuar me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave” – Lot 2, me Nr. të Prok: 616-22-14684-5-1-1”.**
3. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues me datë: 31.03.2023 ka bërë publik Njoftimin mbi Vendimin për Kontratë lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull:

**“Rikonstruimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave” – Lot 2, me Nr. të Prok: 616-22-14684-5-1-1**

Ju si Operator Ekonomik keni ushtruar të drejtën e juaj për Kërkesë për Rishqyrtim, pra me datë: 04.10.2022, ku keni paraqitur pretendimet ankimore si në vijim:

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtuajshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 57 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 64 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 10 i Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurim Publik.

### 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Të nderuar ne me dt.31.03.2023, kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku e kemi rekomanduar për kontratë për Lot 2 OE “GURËBARDHI” SH.P.K., ndërsa neve na keni shpallur si tenderues të pasuksesshëm me arsyetimin se nuk e kemi dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët.

Filimisht ju sqarojmë se ne kemi pasur qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë për Lot 2 dhe pas analizimit të dokumenteve kemi ardh në përfundim se është rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

1. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën tek neni 13.1&13.2 të FDT-së-Siguria e tenderit ku është specifikuar saktë se vlefshmëria e sigurisë së tenderit është 120 ditë.

Ky OE nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë ka prezantuar sigurimin e tenderit vetëm për 90 ditë dhe jo 120 siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Tek Udhëzuesi nr.001/2023 Për Prokurimin Publik, përkatësisht tek neni 10-Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve është specifikuar qartë se:

<b>Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT</b>	<b>Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.</b>	<b>57</b>
---	---	-----------

Përderisa sigurimi i tenderit të OE të rekomanduar për kontratë nuk i përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde -pjesë e dosjes së tenderit, atëherë është i qartë fakti se i njëjti është OE i papërgjegjshëm dhe një gjë të tillë është dashur ta konfirmoni edhe ju si autoritet kontraktues. Në sigurimin e tenderit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë shkruan qartë “Kjo siguri vlen 90 ditë kalendarike prej 15.02.2023 deri më 16.05.2023”.

Sigurimi i tenderit është lëshuar nga kompania e sigurimeve Elsig me dt.15.02.2023 Nr.110675 dhe në këtë Deklaratë të garantuesit shkruan “Kjo siguri vlen 90 ditë kalendarike prej 15.02.2023 deri më 16.05.2023”.

Edhe në policën e sigurimit të garancisë së tenderit shkruan qartë, si në vijim:

<b>Mbulueshmëria e Polices</b>	
<b>Shuma Siguruar</b>	<b>5,000.00</b>
<b>Periudha Sigurimit</b>	<b>15.02.2023 - 16.05.2023</b>
<b>Primi</b>	<b>50.00</b>
<b>Tvsh</b>	<b>9.00</b>
<b>Primi Bruto</b>	<b>59.00</b>
<b>Data e lëshimit</b>	<b>15.02.2023 09:06</b>

Autoriteti kontraktues ka përcaktuar kushtet e sigurimit të tenderit sipas **nenit 57 të LPP-së paragrafi 4.2.Shuma e saktë e sigurimit të tenderit dhe periudha e nevojshme e vlefshmërisë për sigurimin e tenderit;**

Përderisa janë përcaktuar kushtet e sigurimit të tenderit në FDT, sipas kësaj dispozite të LPP-së atëherë duhet ti përmbahen të gjitha operatorët ekonomik, kurse në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë nuk ju ka përmbajtur kërkesave të FDT-së në lidhje me nenin 57 të LPP-së, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Neni 28.6 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik shkruan qartë:

**28.6 Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit.**

Në nenin 21.1 të FDT-së është e cekur që Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: 90 ditë, prandaj sigurimi i tenderit është dashur të jetë 30 ditë më shumë, pra 120 ditë ashtu siç është kërkuar në FDT;

prandaj pa u lëshuar në vlerësim të mëtutjeshëm, autoriteti kontraktues është dashur ta eliminojë OE e rekomanduar për kontratë.

2. I njëjti OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, tek kapaciteti teknik dhe profesional, ku është kërkuar "Operatori ekonomik për Lot1 dhe Lot 2 duhet të ketë Baze për prodhimin apo marrëveshje për furnizimin me- a) Asfalt", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Kopjet e Licencave të vlefshme për vitin 2023 e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale".

Në lidhje me kërkesën e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një ofertë një marrëveshje për furnizim me asfalt të lidhur me kompaninë SB CONSTRUCTION SH.P.K, ndërsa kjo kompani posedon licencën e lëshuar nga agjensioni për miniera dhe minerale, e cila ka afat valid deri më dt.18.04.2023. Licenca e tillë është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit, sepse kërkesa ka qenë shumë e qartë që licencat duhet të jenë të vlefshme për vitin 2023, ndërsa licenca e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është valide për të gjithë vitin 2023 sepse të njëjtës i skadon validiteti ende pa filluar punët fare.

Andaj duke u bazuar në këtë fakt licenca e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është prezantuar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe ju është dashur të njëjtin ta eliminoni nga ky aktivitet i prokurimit, pasi që i njëjti është OE i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse në paragrafin 4 të kësaj dispozite shkruan qartë "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Në këtë rast tenderi i OE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Po ashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore duke e rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm.

## Baza Ligjore për aprovim të pjesërishëm të Kërkesës për Rishqyrtim

Operatori Ekonomik ankimor Haxha KOM ka paraqitur provat se Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës Gurëbardhi shpk ka dorëzuar sigurimin e tenderit në kundërshtim me dispozitat e dosjes së tenderit ku është kërkuar që sigurimi i tenderit duhet të jetë valid për 120 ditë, ndërsa operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar polisën e sigurimit të tenderit në validitet prej 90 ditësh.

Autoriteti Kontraktues duke zbatuar nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, poashtu nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik si dhe kriteret e dosjes së tenderit dhe në bazë të shqyrtimit të provave të prezantuara nga OE ankimor Haxha Kom shpk si dhe respektimit të dispozitave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik në nenin 57 e cila thekson

Sigurimi i tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë të FTD-së	Refuzo tenderit pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm. 57.
---	--

Sa i përket pretendimet të dytë Autoriteti Kontraktues në bazë të shqyrtimit ligjor dhe provave konstaton që OE përmbush kriterin për marrëveshjen me asfalt pasi që e ka për vitin 2023 dhe është përmbushur kriteri në dispozitën e dosjes së tenderit 9.1 dhe 9.2. Andaj ky pretendim ankomor është i pabazuar.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

**Departamentit të Prokurimit**  
**Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi**  
**Arkivit**

**Visar Shehu – U.D. i Departamentit të Prokurimit**



5